

PROGRES RAPORTI 2009 I KOMISIONIT EVROPIAN PËR SHQIPËRINË, NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK

Ka patur disa përmirësime në fushën e prokurimit publik. Në muajin Janar 2009 u miratua legjislacioni, i cili njeh detyrimin e autoriteteve kontraktore për të përdorur prokurimin elektronik. Autoritetet kontraktore gjithashtu duhet të publikojnë të gjitha njoftimet që kanë lidhje me procedurat e prokurimit dhe dokumentat e tenderit në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Kjo gjë ka përmirësuar aksesin për informacion dhe ka ndihmuar në uljen e kostove procedurale. APP ka siguruar këshillim dhe mbështetje për të kapërcyer problemet teknike të ndeshura fillimisht. Megjithatë, ka disa sygjerime në lidhje me përdorimin e procedurave elektronike. Përpjekjet duhet të vazhdojnë për t'i shtrirë ato në të gjitha llojet e prokurimit publik. Procedurat elektronike kanë për qëllim uljen e mundësisë për korrupsion, megjithëse përpjekje të mëtejshme kërkohen në të gjitha fazat e procesit të prokurimit.

Kuadri ligjor nuk ka ndryshuar në thelb. Përafrim i mëtejshëm me legjislacionin e BE-së kërkohet përse i përket sektorëve utilitarë dhe konçesioneve. Procedurat për trajtimin e ankesave akoma nuk janë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare. Akoma nuk është ngritur një organ i pavarur për rishikimin e ankesave. Vendimet mbi ankesat vazhdojnë të merren nga Agjencia e Prokurimit Publik, e cila është përgjegjëse për interpretimin e ligjit dhe dhënien e këshillimit ligjor për autoritetet kontraktore.

Kapacitetet e APP-së janë forcuar përmes aktiviteteve trajnuese, duke përfshirë pjesëmarrjen në seminare të organizuara nga organizata ndërkombëtare. Megjithatë, funksioni i APP-së si organ qëndror koordinimi dhe këshillimi duhet të forcohet. Kjo e fundit ka siguruar trajnime dhe informacion për autoritetet kontraktore dhe komunitetin e biznesit në lidhje me procedurat dhe legjislacionin e prokurimit publik. Gjithsesi, ndihmesë e mëtejshme nevojitet për autoritetet kontraktore dhe furnizuesit. Përpjekje kërkohen

për të përmirësuar njohuritë e gjyqtarëve rreth legjislacionit të prokurimit publik si dhe zbatimit të tij.

Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e prokurimit publik janë duke avancuar në mënyrë të moderuar. Përafrim i mëtejshëm i legjislacionit kërkohet dhe zbatimi i tij duhet të forcohet.